

Home > Aktualitet > Atentat Paulin Harushës! 23-vjeçarit i zënë pritë në Theth, shkon vetë i plagosur...

AKTUALITET

Atentat Paulin Harushës! 23-vjeçarit i zënë pritë në Theth, shkon vetë i plagosur në qendrën shëndetësore, s’ka rrezik për jetën

23-vjeçari, i cili po qarkullonte me mjetin e tij, ka mbetur i plagosur nga të shtënat ndaj tij, megjithatë ka mundur që të shkojë vetë në qendrën shëndetësore për të marrë ndihmën e parë nga mjekët.



Foto ilustruese

9 Gusht, 2021 20:58

SHKODËR– Paulin Harusha po qarkullonte me mjetin e tij nga Thethi në drejtim të fshatit Nderlyisë, ku disa persona të armatosur i kanë ‘prerë rrugën’ duke e qëlluar me armë zjarri.

23-vjeçari, i cili po qarkullonte me mjetin e tij, ka mbetur i plagosur nga të shtënat ndaj tij, megjithatë ka mundur që të shkojë vetë në qendrën shëndetësore për të marrë ndihmën e parë nga mjekët.

Deri më tani raportohet se i riu është jashtë rrezikut për jetën dhe se ia ka hedhur sulmit me vetëm një gërvishtje të vogël. Por edhe pse në gjendje të mirë shëndetësore, nuk ka mundur që të ndihmojë “blutë” e zonës, pasi ka deklaruar se nuk i ka njohur personat që i kanë dalë para pritë dhe kanë shtënë në breshëri ndaj tij për shkak të errësirës.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](#)

I riu Paulin Harusha nuk rezulton se ka pasur precedent të mëparshëm kriminal, megjithatë Policia ka nisur nga puna për kapjen e autorëve, edhe pse në zonë mundojnë edhe kamerat e sigurisë.

(k.m/dosja.al)

21:19 - **‘S’i dallova dot!’/ I zunë pritë teksa kthehej në fshat, 23-vjeçari ‘ngre supet’ para Policisë: Atentatorët e mi...**




Foto ilustruese

Paulin Harusha është në gjendje të mirë shëndetësore por sërish nuk ka mundur që të identifikojë personat që qëlluan me armë zjarri ndaj tij. Pasi është mjekuar për plagën e marrë gjatë atentatit që i kishin organizuar, ai tha për Policinë se nuk i kishte njohur personat që qëlluan ndaj tij. Kjo edhe për shkak të errësirës.



21:25 - **Njoftimi i plotë i policisë:**

Njoftimi i plotë i policisë:

Shkodër/Informacion paraprak

Në qendrën shëndetësore të Thethit është paraqitur për ndihmë mjekësore, jashtë rrezikut për jetën, shtetasi P. H., 23 vjeç, i cili në rrethana ende të paqarta, duke qarkulluar me mjetin e tij nga Thethi në drejtim të fshatit Nderlyisë, dyshohet se është plagosur me armë zjarri. Në vendngjarje kanë shkuar shërbimet e Policisë dhe grupi hetimor dhe nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër vijon puna për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit.



ETIKETA: [#Paulin Harusha](#) [#plagoset Paulin Harusha](#) [#plagosje ne theth](#)

11

SHARES



Previous article

VIDEO/ Fitoi medaljen e artë në atletikë me Italinë, Jacobs pritet në aeroport si hero

Next article

Aksion anti-kanabis në Krujë! Asgjësohen 100 bimë, dy në kërkim nga Policia

Shto Koment

Emri Juaj*

E-Mail*

Komenti Juaj*

Dërgo

POSTIME TË NGJASHME

Aktualitet



Flakët arrijnë mbi tunelin e Kalimashit, era ndihmon në përhapjen e zjarrit

Aktualitet



‘S’i dallova dot!’/ I zunë pritë teksa kthehej në fshat, 23-vjeçari ‘ngre supet’ para...

Aktualitet



Aksion anti-kanabis në Krujë! Asgjësohen 100 bimë, dy në kërkim nga Policia


Aktualitet



Situata me zjarret/ VOA: Shqipëria me teknikën më të prapambetur në Europë



STAY CONNECTED



LAJMET E FUNDIT



9 Gusht, 2021 21:27

Flakët arrijnë mbi tunelin e Kalimashit, era ndihmon në përhapjen e zjarrit




9 Gusht, 2021 21:23

Raporti i OKB-së për klimën: Ngrohja globale me 1,5 gradë arrihet që në 2030-n



9 Gusht, 2021 21:19

‘S’i dallova dot!’/ I zunë pritë teksa kthehej në fshat, 23-vjeçari ‘ngre supet’ para Policisë: Atentatorët e mi...



9 Gusht, 2021 21:02

Aksion anti-kanabis në Krujë! Asgjësohen 100 bimë, dy në kërkim nga Policia

Aleanca për Media Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

Stafi

Drejtör : Enton Abilekaj
Kryeredaktor : Fjola Graçi

Gazetarë :
Kejsi Muça
Dezdemona Kolaveri
Izmir Akulli
Daniela Andrellari

Florida Mingla
Alberta Boseta
Kleida Muka
Eda Kola